




REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO		AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	2-0/DPK	Nr. Prot.	01-1374/2012
Br. Prot.		Prot No.	
Nr. I faq.		Data	17-04-2012
Broj stranica	02	Datum	
Nr. pages		Date	
PRISHTINË			



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE  
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë **30.03.2012**, nxjerr këtë:

### V E N D I M

**I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-4796/11, për znj. *Nazane BRECA* – Deputete e Kuvendit të Kosovës, për shkak se është shmangur situata me konflikt interesi në të cilën ndodhej kjo zyrtare e lartë publike.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

### A r s y e t i m

**I. Në lidhje me rastin nr. AKK-03-4796/11 të hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në ushtrimin e funksionit publik, për Zyrtaren e lartë, Nazane Breca – Deputete në Kuvendin e Kosovës, janë ndërmarrë veprimet sipas procedurës së paraparë ligjore, të nevojshme për këtë situatë (Ligji Nr.04/L-051, Neni 18, pika 1).**

Pas identifikimit të rastit me dyshimin e bazuar për ekzistimin e konfliktit të interesit, që shfaqej nga ushtrimi i dy funksioneve të papajtueshme, një si Deputete në Kuvendin e Kosovës, dhe ushtrimi i funksionit drejtues të biznesit privat, Qend.Diag.Tera."Kujdesi Familjar", Zyrtares së lartë, i është bërë shkresa e parë njoftuese nga Agjencia Kundër Korrupsionit – AKK, me datën 29.02.2012 (Neni 18, paragrafi 5, Ligji Nr.04/L-051).

Kësaj shkrese Zyrtarja e Lartë, i është përgjigjur me datën 12.03.2012 dhe po të njejten ditë, ajo me vete ka sjellë dokumentin zyrtar "Njoftim për Shuarje", të lëshuar nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë, në të cilin shihet se biznesi në fjalë dhe funksioni që Zyrtarja e lartë kishte në te, e që e sillte në situatë të konfliktit të interesit, është shuar në mënyrë vullnetare. Dokumenti mban numrin e protokolit DPK/DPKI 03-1003/2012.

Kështu, me këto informacione zyrtare mbi biznesin, të lëshuara nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve, kemi konstatuar se është shmangur situata konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, gjithnjë duke u bazuar në Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (Nr.04/L-051) .

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)

Drejtore i Agjencisë Kundër Korrupsionit

/ Hasan Preteni /

